

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.06.09.2023*

**06.09.2023
Ora 16:34**

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për shqyrtimin e kërkesës së “Partisë Demokratiane të Shqipërisë”, për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 Shtator 2023”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ:**
- **Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**
- **Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, znj. P. Doçaj**
- **Parti Politike: S’ka prezent**
- **Të tjerë: KRIIK**

Z. I. Celibashi: Atëherë, në seancë kemi për shqyrtim dy çështje: shqyrtimi i kërkesës Partisë Demokratiane për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor si dhe projektvendimi “Për caktimin e vendit të numërimit të votave për KZAZ-në nr. 11 për zgjedhjet për kryetar të Bashkisë Kukës data 24 shtator 2023”. Po!

Z. Y. Merkaj: Faleminderit, Partia Demokratiane e Shqipërisë nëpërmjet kryetarit të saj zotit Nard Ndoka, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për tu regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e datës 24 shtator 2023 për kryetarin e Bashkisë Kukës. Partia Demokratiane ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë vijon:

- vërtetimin e lëshuar nga zyra e regjistrimit të partive politike;

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.06.09.2023*

- deklarimin e angazhimit solem të kryetarit;
- deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike;
- emrin zyrtar të partisë;
- shkronjat nistore si dhe adresën e partisë;
- emrin e kryetarit të partisë;
- emrin e financierit;
- emrin e personit përgjegjës për komunikimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si dhe,
- specimenin e vulës së partisë të paraqitur nga ky subjekt zgjedhor.

Për sa më sipër i propozojmë Komisionerit marrjen në shqyrtim dhe miratim të këtij projektvendimi, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Mirë atëherë, miratohet regjistrimi i Partisë Demokristiane të Shqipërisë me kryetar zotin Nard Ndoka, me shkronja nistore PDK, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Kukës të datës 24 shtator 2023.

Vendimi nr. 762

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.06.09.2023*

**06.09.2023
Ora 16:36**

RENDI I DITËS

**Projektvendimi “Për caktimin e Vendit të Numërimit të Votave të KZAZ-së nr. 11,
për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 Shtator 2023”.**

PJESËMARRJA :

- **KQZ:**
- **Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**
- **Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, znj. P. Doçaj**
- **Parti Politike: S’ka prezent**
- **Të tjerë: KRIIK**

Z. I. Celibashi: Pika e dytë e rendit të ditës!

Z. Y. Merkaj: Referuar nenit 94 të Kodit Zgjedhor, prefekti i qarkut i paraqet Komisionit Qendror të Zgjedhjeve listën e objekteve brenda territorit të qarkut, i cili plotëson kushtet për caktimin e vendit numërimit të votave të KZAZ-ve përkatëse. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga prefekti i qarkut, i cili në datën 04.09.2023, ka dërguar listën e objekteve, në të cilën janë dy objekte: palestra e shkollës nëntëvjeçare “Lidhja e Prizrenit” dhe palestra e gjimnazit “Hafzi Nela”. Prefekti referon se ambjenti i dytë nuk i plotëson kriteret pasi është ende në rikonstrukcion. Në këto kushte ambjenti i vjetër që i plotëson kriteret për t’u përdorur si vend i numërimit të votave në KZAZ-në nr. 11 është palestra e shkollës nëntëvjeçare “Lidhja e Prizrenit”. Ky ambjent ka shërbyer në zgjedhjet e 14 majit si

***Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU***



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.06.09.2023*

vend i numërimit të votave. Gjithashtu edhe nga inspektimi i inspektorëve të KQZ-së është parë dhe plotëson kriteret për t'u përdorur si VNV. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim e miratim, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Mirë atëherë, caktohet palestra e shkollës “Lidhja e Prizrenit” në Kukës si vend i numërimit të votave për KZAZ-në nr. 11 të Bashkisë Kukës, çështje të tjera nuk kemi?

Z. Y. Merkaj: Jo nuk kemi!

Z. I. Celibashi: Mirë, seanca mbyllet, faleminderit.

Vendimi nr. 763

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

